



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II nr.261/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitia Ymeri anëtar, në çështjen juridike të paditësit S.S nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Bordi i ankesave, me bazë juridike: tatim në pronë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit A.2375/18 dates 17.11.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative,Divizioni Fiskal, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, SHPALLET JOKOMPETENTE në pikëpamje lëndore për vendosjen e çështjes konkrete juridike.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, lënda do t'i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, si gjykatë kompetente për vendosjen e kësaj çështje, sipas ankesës datë 07.12.2020 të palës paditëse kundër Aktgjykimit A.nr.2375/18 datë 17.11.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje administrative,Divizioni Fiskal.

A R S Y E T I M

Paditësi S.S nga Prishtina me datë 07.12.2020 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit A.nr.2375/18 datë 17.11.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vepruar sipas detyrës zyrtare konform nenit 19 të LPK-së, pasi ka shqyrtuar bazën ligjore për të vendosur në këtë çështje ka konstatuar se kompetent për të gjykuar në këtë lëndë është Gjykata e Apelit në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative. Këtë konstatim Gjykata e ka mbështetur në petitumin e padis e datës 02.10.2018, aktgjykim i kontestuar, ankesa e paditësit, si dhe dispozitat e nenit 13 të Ligjit nr.08/L-15 për Gjykatën Komerciale.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në kuptim të nenit 17, 18, 19, 29 dhe 392 pika b) të LPK-së, dhe Ligjit nr.08/L-15 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Dh.Shk.II nr.261/22 dt.05.09.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha